

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.M., nga fshati ... Komuna e Skenderajt, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit R.M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, P.nr.217/2018, datë 25.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit R.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, P.nr.217/2018, datë 25.10.2018, **vërtetohet**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, me aktgjykimin P.nr.217/2018, datë 25.10.2018, të akuzuarin R.H., për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtorë dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në vlerë prej 300 €, të cilin dënim është obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë ky dënim do ti zëvendësohet në bazë të nenit 46 par. 3 të KPRK-së. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 60 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 10 €, të cilat është obliguar ti paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari R.H., për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoja ashtu që të akuzuarin ta liroj nga akuza ose ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1284/2018, datë 17.12.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, i akuzuari në ankesë pretendon se, gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur aktgjykimin në prova të papranueshme apo në një provë të vetë të dëmtuarit. Vendi ku ka ndodhur aksidenti është vend i frekuentuar dhe vend ku është e pamundur që të mos ketë ndonjë dëshmitarë në këtë rast. Se i akuzuari ka qenë tërësisht i ndalur para vendkalimit për këmbësor duke pritur këmbësorët tjerë të kalojnë vendkalimin, tani i dëmtuari ka qenë së bashku me dy persona të tjerë në anën e djathtë timen dhe papritmas ka dashur të dal në anën e majtë jo në vendkalim dhe ai është mbështetur në pjesën e prapme të veturës së të akuzuarit me të dy duart e jo se e ka goditur automjetin e të njëjtit me këmbë. Gjykata nuk ka ftuar dëshmitarët e rastit sikurse janë kalimtarët e rastit që i kanë ndihmuar të dëmtuarit që të shkoj në spital, pasi atë e ka lëshuar këmba. Se eksperti i komunikacionit shumë lehtë ka konstatuar lëshimet e të akuzuarit, por pa analizuar fare mendimin e tij dhe provat tjera të lëndës. I akuzuari po ashtu thekson në ankesë se e ka kundërshtuar mendimin e ekspertit në gjykim dhe se arsyetimi se me këtë mendim gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike sipas të akuzuarit për të janë shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse ai mendim nuk është krahasuar me gjendjen faktike në vendin e ngjarjes, andaj mendon se kjo këto prova janë të papranueshme.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i gjykatës se shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në të cilat thirret i akuzuari në ankesën e tij, aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Aktgjykimi i shkallës së parë, pra edhe dispozitivi është mjaft i qartë dhe pa kundërrthënie me vetveten dhe me faktet e cekura në arsyetim. Në arsyetim janë përshkruar në mënyrë të qartë elementet inkriminuese të të akuzuarit që përbëjnë veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtorë, pra mënyra se si i akuzuari ka kryer veprimet inkriminuese me datë, vend dhe kohë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, veprime këto që përmbajnë elementet qenësore të veprës penale për të cilat i njëjti me të drejtë është shpallur penalisht përgjegjës dhe i është shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Po ashtu pretendimet e të akuzuarit se gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur aktgjykimin në prova të papranueshme apo në një provë të vetë të dëmtuarit, sipas kolegjit penal të kësaj gjykate nuk qëndrojnë ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar në kuptim të dispozitës së nenit 262 par. 1 të KPPK-së, ku parashihet se: “Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një provë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar ku në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 24.10.2018, meqenëse në shqyrtimin gjyqësor nuk është paraqitur i dëmtuari J.J., prokurori i shteti ka propozuar gjykatës që të lexohet deklarata e të njëjtit e dhënë në stacionin policor në Skenderaj me datë 06.06.2016, në shqyrtimin gjyqësor, ku i akuzuari nuk e

ka kundërshtuar propozimin e prokurorit të shtetit, po ashtu gjykata e shkallës së parë përveç deklaratës së të dëmtuarit ka administruar edhe provat e tjera të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësor si raporti i rastit të policisë së Kosovës me datë 06.06.2016, raportin mjekësor konstatimin dhe mendimin e ekspertit për llojin dhe peshën e lëndimeve të datës 24.05.2018, fotodokumentacionin e vendit të ngjarjes si dhe konstatimin dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit të datës 25.06.2018, andaj, pretendimet e të akuzuarit në këtë drejtim nuk janë të bazuara. Në këtë drejtim aktgjykimi përmban edhe arsye të qarta dhe është bazuar në fakte dhe prova të mjaftueshme përkitazi me fajësinë e të akuzuarit.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, i akuzuari në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar asnjë fakt të rëndësishëm lidhur me rastin në fjalë, ngase në vendin ku ka ndodhur aksidenti është vend i frekuentuar e mund të ketë edhe kamera të vendosura në ndërtesën e Kuvendit Komunal, se nuk e ka vërtetuar se në cilën anë ka qenë i dëmtuari kur ka filluar kalimin e rrugës. Se i akuzuari është lënduar në këmbën e djathtë, ku përjashton mundësinë të jetë lënduar në këtë aksident sepse i njëjti sikurse që ka deklaruar edhe vetë ka qenë duke qëndruar para ndërtesës së kuvendit komunal, por këtë fakt nuk e kanë marrë parasysh gjykata e shkallës së parë. Kjo bëhet edhe më bindëse kur dihet se mjeku ekspert nuk e ka vizituar fare as në seancë e as jashtë seancës të dëmtuarin i cili kishte konstatuar se i dëmtuari fare nuk ka mundur të ec, apo se këto lëndime janë në ndonjë rast më herët dhe të matet lartësia e pjesës me të cilën e kam goditur. Prandaj, në bazë të gjitha këtyre i akuzuari konsideron se nuk është vërtetuar gjendja faktike, duke ja falur besimin prova të pambështetura.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore të akuzuarit, nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikurse pa të drejt pretendohet në ankesën e ushtruar. Se i akuzuari, ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë gjykata e shkallës së parë nga provat e shtjelluara në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimin veç e veç, si dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar gjendjen faktike, se i akuzuari me kohë datë dhe vend sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar ka kryer veprimet e kundërligjshme të cilat i janë vënë në barrë me anë të aktakuzës. Sipas kolegjit penal të kësaj gjykate me të drejtë gjykata e shkallës ka vërtetuar këtë gjendje faktike duke administruar provat dhe atë: deklaratën e të dëmtuarit J.J. të dhënë në policinë e Kosovës me datë 06.06.2016, si dhe provat materiale raporti i rastit të policisë së Kosovës me datë 06.06.2016, raportin mjekësor konstatimin dhe mendimin e ekspertit për llojin dhe peshën e lëndimeve të datës 24.05.2018, foto dokumentacionin e vendit të ngjarjes si dhe konstatimin dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit të datës 25.06.2018. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar faktin dhe atë me leximin e deklaratës së të dëmtuarit të dhënë në policinë e Kosovës me datë 06.06.2016, në shqyrtimin gjyqësor e ka lexuar me propozimin e prokurorit të shtetit dhe me pëlqimin e të akuzuarit, ku ndër të tjera ka theksuar se derisa ka qenë duke kaluar në vendkalim për këmbësor, ka ardhur një automjet dhe e ka goditur në këmbën e djathtë, pastaj sapo e ka goditur shoferi i automjetit është ndalur dhe e ka pyetur se a është

lënduar dhe ky i ka thënë se është mirë dhe se nuk ka nevojë për mjek, atëherë shoferi ka vazhduar rrugën ndërsa ky ka mbetur para komune dhe ka vërejtur se këmba nuk e mbante dhe pas kësaj ka shkuar në emergjencën e Shtëpisë së Shëndetit në Skenderaj. Nga ekspertiza e komunikacionit e punuar nga ekspertja N.S.-A. e datës 25.06.2018, ka konstatuar se aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të akuzuarit, i cili nuk është ndalur ti jap përparësi këmbësorit por lëvizë dhe e godet atë. Po ashtu nga raporti i aksidentit i hartuar nga Policia e Kosovës me nr. 2016-BR-401, datë 06.06.2016, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar faktin se ditën kritike ka ndodhur aksidenti i përshkruar, sikurse që vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës. Po ashtu gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar faktin edhe nga ekspertiza mjeko-ligjore e punuar nga Dr. F.B. datë 01.06.2018, se nga aksidenti i komunikacionit lëndime të natyrës së lehtë trupore ka pësuar i dëmtuari J.J., dhe atë ndrydhje të indeve të buta të gjurit të djathtë, të shkakuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të furishëm si pasojë e aksidentit në trafik. Sipas kolegjit penal të kësaj gjykate me të drejtë gjykata e shkallës së parë i ka falur besimin provave të lartë cekura, e në bazë të së cilave është vërtetuar fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë ngase të njëjtat janë në përputhmëni me njëra tjetrën, e po ashtu me të drejtë ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit ku nuk ia fali besimin ngase e njëjta është në kundërshtim me provat materiale dhe në drejtim të shmangies së përgjegjësisë penale. Një gjendje të tillë faktike si të drejtë dhe të ligjshme e aprovoj edhe kjo gjykatë.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal i akuzuari në ankesën e tij pretendon se në Kodin Penal parashihen rrethanat lehtësuese dhe rënduese për kryesin e veprës penale, por parasheh edhe fakte të cilat gjykata duhet ti ketë parasysh pra to që përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit sikur në këtë rast. Kur ka gjetur gjykata se ka kryer veprën penale duke i besuar plotësisht deklaratës së të dëmtuarit si dhe mendimit të ekspertit, por nuk ka vërtetuar faktet se i njëjti nuk është fajtor. Po të veprohej sipas kodit i akuzuari pretendon se gjykata do të nxjerrte prova tjera të cilat do të vërtetonin faktin se i akuzuari nuk ka qenë shkaktar i aksidentit qoftë edhe nga pakujdesia. Andaj, sipas të njëjtit, në bazë të këtyre të lartcekurave, vërehet shkelja e kodit penal.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit, pretendimet e lartcekura të akuzuarit për shkelje të ligjit penale i vlerëson si të pabazuara, pra kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarin e ka shpallë fajtorë për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e cila i është vënë në barrë me akuzë. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsye për veprimet inkriminuese të tij. Kolegji i kësaj gjykate, ka ardhur në përfundim se nuk është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit, se vepra penale për të cilën ndiqet i akuzuari përbën vepër penale, se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale, nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, se është zbatuar ligji i aplikueshëm. Meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat për matjen, zbutjen ose ashpërsimin e dënimit kundër të akuzuarit kur janë shpallur fajtorë për veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk kundërshtohet sa i përket vendimit për dënim, kolegji penal i kësaj gjykate aktgjykimin e shkallës së parë e shqyrtoj në këtë drejtim sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 396 të KPPK-së dhe gjeti se nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të dispozitave ligjore, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar sjelljen e tij korrekte para gjykatës, se veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, ndërsa si rrethana rënduese në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson se dënimi me gjobë i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore dhe është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr. 1281/18, datë 26.10.2018

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Shqipe Qerimi